

JULJANA KUME

**TIPOLOGJI TË HUAZIMEVE GREKE
NË TË FOLMET ARBËRESHE**

Hyrje

Punimi rreth klasifikimit të elementit grek në të folmet arbëreshe sipas tipologjive përkatëse vjen në kuadër të një studimi të thelluar analizues leksiko-morfologjik të leksikut të të folmeve arbëreshe, veçanërisht të rajonit të Kalabrisë, referuar fillimisht veprës së vetme leksikografike arbëreshe “Fjalorit të arbëreshëvet t’Italisë” së E. Giordanos, si dhe fjalorthëve, studimeve leksikore të katundeve të ndryshme arbëreshe kryesisht ato të realizuara vitet e fundit nga Katedra e albanologjisë në Kalabri (Kozenca) e për të vijuar me analizimin leksikor të veprave letrare të shkrimtarëve arbëreshë, në mënyrë që të plotësohet kuadri i studimeve leksikore.

Në një këndvështrim të përgjithshëm, studimi i ndërmarr në mbështetje të Katedrës Albanologjike të Universitetit të Kalabrisë, përkatësisht prof. F. Altimarit, është menduar të fillojë me evidentimin dhe listimin e huazimeve leksikore greke që shquhen lehtësisht gjatë dëgjimit ose gjatë procesit të leximit. Këtu bëhet fjalë për ato njësi që kanë frekuencë më të lartë përdorimi gjatë ligjërimit të përditshëm në të folmet përkatëse të rajonit të Kalabrisë. Pasqyrimi dhe klasifikimi i disa prej tyre sipas prapashtesave me frekuencë më të lartë përdorimi, përbën dhe qëllimin kryesor të punimit përkatës.

2. Zhvillimi

Albanofonia kalabreze, pasqyrë e historisë gjuhësore të arbëreshëve të Kalabrisë, është përziere ose kryqëzim kodesh gjuhësore të disa gjuhëve, të cilat bashkëjetojnë prej shekujsh në të folmet e këtij komuniteti të shtrirë në disa fshatra brenda rajonit të Kalabrisë.

Arbërishtja e Kalabrisë ndodhet në një tërësi arkipelagësh gjuhësorë minoritarë. Arbërishtja është një variant dialektor i gjuhës shqipe, pjesë e gjuhës së përbashkët panshqipe. Në komunitetin arbëresh, historikisht kanë ndërvepruar shumë sisteme gjuhësore, që në momente të ndryshme

historike dhe kulturore kanë pasur role dhe lidhje të ndryshme sociolinguistike, duke e përkufizuar kështu arbërishten si një sistem gjuhësor kompleks i huazimeve të depozituara. Sistemet gjuhësore kryesore të përfshira janë¹:

- Shqipja ose arbërishtja,
- Italishtja dialektore, meqë ndikimi i varieteteve vendore (lokale) është i madh
- ashtu sikurse është paralelisht ndikimi i italishtes (zyrtare ose standarde) si gjuhë e shkruar dhe e folur.
- Për të mos anashkaluar dhe ndikimin e ushtruar të **greqishtes** mbi arbërishten e Kalabrisë, që vazhdon të jetë gjuha liturgjike në komunitetet e ritit katolik-bizantin të Eparkisë së Lungros dhe që ka pasuruar strukturën leksikore të italo-shqipes me një përqindje të lartë të huazimeve që karakterizojnë fusha të ndryshme si të ekonomisë shtëpiake, të agrikulturës, artizanatit përveç leksikut liturgjik.

Referuar “Fjalorit të arbëreshëvet t’Italisë”², literaturë bazë e këtij punimi, pasi sot për sot është e vetmja vepër e mirëfilltë leksikografike që zotërojnë të folmet arbëreshe, kemi mundur të evidentojmë afërsisht 767 njësi leksikore greke nga 19.000 njësi të pasqyruara në tërësinë e fjalorit, veçanërisht përfshirë këtu, ato që janë lehtësisht të evidentueshme si elemente greke dhe që përdoren shpesh gjatë ligjërimit të përditshëm apo veprimtarisë jetësore të botës arbëreshe.

Njësitë greke të ligjërimit arbëresh janë kryesisht të fushave të mëposhtme leksiko-semantike, të renditura me rend zbritës sipas % më të lartë të njësive të përfshira në fushat përkatëse leksiko-semantike:

- **Kushte fizike, psikologjike dhe emocionale:** *vares “mërzitem”; nakatos-je “përziej”, lipi “zi”, lipisi “dhembshuri”; ftes “vë në faj”; farmakos “helmoj”; metanos “pendoj”; zili-a, zileps-ënj “dëshiroj me ndjesinë e xhelozisë”; pataks “çudis”; spuvis*

¹ F. Altimari, *Disa ndikime të greqishtes në fjalëformimin foljor të arbërishtes së Italisë*, Studia Linguistica Italo-Albanica, Arbërishtja në kontekstin gjuhësor ballkanik dhe italian, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Botime të veçanta CXXXIX, Seksioni i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Libri 51. Prishtinë 2014, f. 113.

² E. Giordano, *Fjalori i arbëreshëvet të Italisë*, 2000.

“ngordh”; *sos “mbaroj”*; *hare-ja “gëzim”*; *anangas “ngacmoj”*; *andiris “kundërshtoj diçka që nuk më pëlqen”* etj.

- **Jeta sociale, kulturore dhe civile:** *djavar/ënj “lexoj”*; *putisënj “ujis, vadis”*; *martir-i*; *taks “premtot”, stis “ndërtoj”*; *kollpanis-ënj “qëlloj me shkop”*; *ngales “denoncoj”* etj.
- **Mjetet artizanale, agrikulturore dhe blegtorale:** *dhikrijan-i “çfurk”*; *argali-a “tezgjah”*; *tiravol-i “rrjetë për të kulluar djathin”*; *hjravol-i*; *sfinë-a “kunjz”* etj.
- **Fenomenet natyrore dhe mjedisore:** *filaqi-a “burg”*; *kalive “kasolle”*; *katoq-i “magazinë nëntokësore e një shtëpie”*; *pisë “ferrë”*; *theristi “qershori”*; *llunar “korriku”* etj.
- **Pjesët e trupit dhe veshjet:** *kurm-i*, *cakule-ja*; *carihe*; *cohë-a*, *kaliqe-ja*; *skutinë-a*; *takun-i*, *kafkall-i*, etj.

Nga greqizmat e depërtuara në të folmet arbëreshe, afërsisht 5% të leksikut e zotërojnë foljet dhe emrat dhe shumë pak ndajfoljet apo mbiemrat, të cilat gjatë një harku kohor shumëshekullor kanë depërtuar në fjalëformimin e sistemeve gjuhësore:

- tek të folmet e Çamërisë,
- në toskërishten jugore,
- në të folmet e arvanitasve të Greqisë,
- si dhe në dialektet e Italisë Jugore.

Denduria e elementit grek në të folmet arbëreshe ka vijuar edhe pas shumë shekujsh:

- pas shkëputjes së arbërishtes nga trugu i Ballkanit
- dhe pas ndërprerjes së kontaktit të ngushtë që ajo kishte me greqishten,
- denduria vazhdoi edhe për efekt të hegjemonisë fetare dhe kulturore të greqishtes bizantine në kishën lindore arbëreshe, që zgjati për një pjesë të komuniteteve arbëreshe deri në ditët tona dhe që solli si pasojë asimilimin brenda arbërishtes të një numri të lartë leksemash, sidomos emra dhe folje,
- greqizmat pasuruan fondin e arbërishtes, duke e dalluar atë në krahasim me variantet e tjera të gjuhës.

Studimi leksikor i arbërishtes, përse i përket huazimeve nuk duhet të jetë palidhje nga ajo e gjuhës shqipe origjinale. Pikërisht, këtu për të mos ngatërruar huazimet e pranishme greke dhe latine që kanë ekzistuar në gjuhën shqipe nga huazimet greke dhe romane të kohëve të fundit, të

fituara në të folmet arbëreshe nga të folmet e arvanitasve, si dhe ato italishtes dhe dialekteve të të Italisë së Jugut³.

Pikërisht, pika e mësipërme do të na ndihmojë për grupimin e elementit grek në greqizma të përbashkëta me shqipen dhe në njësi të veçanta që njihen vetëm në botën arbëreshe ose arvanitase të Greqisë.

Ky klasifikim, do të na vijë në ndihmë për të zbuluar rrugën dhe kohën e depërtimit të greqizmave në të folmet arbëreshe. Sjellim më poshtë disa shembuj të huazimeve greke të arbërishtes të përbashkëta me shqipen e sotme p.sh.:

ksister-ra < gr. re η ξίστρα (i ksistra), ksester-ra FGJSSH '80;

kupan-i < gr. re ο κόπανος (o kopanos), kopan-i FGJSSH '80;

sfinë-a < gr. re η σφήνα (i sfina); FGJSSH '80;

kurm-i "trup" < gr. re το κορμί (to kormi), FGJSSH '80;

stafidhe-ja < gr. re η σταφίδα (i stafidha), FGJSSH '80;

nikuqire-ja < gr. re η νοικοκυρά (i nikoqira); nikoqir-i FGJSSH '80;

taks "premtor" < gr. re τάσσω, έταξα (tazo, etaksa), FGJSSH '80;

dhafen-na < gr. re η δάφνη (i dhafni); dafinë-a FGJSSH '80;

qepariz-i < gr. re το κυπαρίσσι (to hjiiparisi, qiparisi); qiparis FGJSSH '80;

kremastár-i "bistak rrushi" < gr. re το κρεμαστάρι (to kremastari), FGJSSH '80;

qiri-u < gr. mes. ose gr. re το κηρί (to qeri), FGJSSH '80;

qoromidhe-ja < gr. re το κεραμίδι (to qeramidhi); qeramidhe-ja FGJSSH '80;

gjiton-i < gr. re ο γείτονας (o gjitonas), FGJSSH '80;

katoq-i "magazinë e katit përdhes" < gr. re το κατώγι (to katogji); katua, katoq, FGJSSH '80.

Sikurse mund të radisim jo pak njësi greke me përdorim të shpeshtë gjatë ligjëritimit të përditshëm vetëm në të folmet arbëreshe p.sh.:

filaqi-a "burg" < gr. re η φυλακή (i filaki, i filahji).

kalive-ja "kasolle, shtëpizë" < gr. re η καλύβα (i kaliva) < gr. vj. καλυβη.

theristi-u "qershor" < gr. re θερίζω, θέρισα (therizo, therisa).

llunar-i "korrik" < gr. re ο αλωνάρης (o alonaris)

³ F. Altimari, *Disa ndikime të greqishtes në fjalëformimin foljor të arbërishtes së Italisë*, Studia Linguistica Italo-Albanica, Arbërishtja në kontekstin gjuhësor ballkanik dhe italian, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Botime të veçanta CXXXIX, Seksioni i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Libri 51. Prishtinë 2014, f. 113.

spuvis/en “të ngordhësh” < gr. re ψοφώ, ψόφησα (psofo, psofisa).
lip-i “zi-ja” < gr. re η λύπη (i lipi).
lipisi-a “dhembshuri” < gr. re η λύπηση (i lipisi).
ftes “të fajësosh” < gr. re φταίω, έφταιξα (fteo, efeksa).
kamnis “tymos” < gr. re καπνίζω, κάπνισα.
kupile-ja “zonjushë” < gr. re η κοπέλα < turq. kopil.

Patrizia Del Puente⁴ është autorja, e cila mbështetur tek “Fjalori i arbëreshëve të Italisë” së E. Giordanos, i ka ofruar studiuesit leksikun e renditur sipas formatit invers, duke na dhënë një panoramë të qartë e të plotë të sufikseve (prapashtesave) të pranishme në të folmet arbëreshe, që është parakusht i domosdoshëm për studimin e morfologjisë arbëreshe. Nga një studim analizues të elementit grek sipas renditjes inverse (së prapthi) të bërë nga autorja Del Puente mund të pohojmë edhe për të folmet arbëreshe se:

- elementi grek si në shqipe, ashtu edhe në arbërishte ka depërtuar si njësi leksikore e parme (njëbërthamëshe).
- Një pjesë e mirë e elementit greke ka krijuar grupe paradigmatiche fjalëformuese d.m.th. çerdhe leksikore, pra është zgjeruar me ndajshesa të tjera me ose pa zhvillime semantike, një ose dy bërthamëshe.
- Njësitë leksikore të krijuara nga tema e parme nuk quhen më huazime greke, por njësi leksikore të shqipes, pasi i përshtaten plotësisht rregullave gramatikore, leksikologjike dhe semantike të gjuhës dhe botëkuptimit shqiptar ose arbëresh p.sh.: *dhistaks/ënj* – *dhistaksi/a* – *dhistaksimë* – *dhistaks/isht*.

Referuar Del Puente po sjellim më poshtë disa tipologji të huazimeve emërore me prapashtesat përkatëse të gjuhës greke sipas frekuencës më të lartë të depërtimit në arbërishte:

- ❖ **Prapashtesa arb. -idh < gr. -ίδα-; -ίδι**
arb. **stafidh/e-ja** < gr. re η σταφίδα (i stafidha) “rrush i thatë”
arb. **alisidh/e-ja** < gr. re η αλυσίδα (i alisidha), it. matassa

⁴ P. Del Puente, Lessico inverso del “Dizionario degli Albanesi d’Italia” di E. Giordano, Università degli Studi di Salerno, Istituto di Linguistica, Cattedra di Glottologia, Napoli, 1991.

arb. **aguridh/e-ja** < gr. re η αγουρίδα (i aguridha) “rrush i papjekur”

❖ **Prapashtesa arb. –ar- < gr. –αρ-**

arb. **kremastár-i** < gr. re το κρεμαστάρι (to kremastari) “vesh rrushi”

arb. **pullar-i** < gr. re το πουλάρι (to pulari) “gomar”

arb. **llunar-i** < gr. re ο αλωνάρης (o alonaris) “korrik”

❖ **Prapashtesa arb. –iq < gr. –ίκ-**

arb. **dhikaniq-i** < gr. mes. ose gr. re το δοκανίκι (to dhokanihi, dhokaniqi)

arb. **kaciq-i** < gr. re το κασίκι (to kaciki, to kaciqi)

arb. **kaliq/e-ja** < gr. re τα καλίκια (ta kalihja) shq. “sandale”

❖ **Prapashtesa arb. –an < gr. –αν-**

arb. **dhikrija-i** < gr. re το δικράνι (to dhikrani), shq. “pirun për gdhendje”

arb. **kupan-i** < gr. re ο κόπανος (o kopanos), shq. “copë druri që shërben për të rrahur diçka ose për të rrahur rrobat”

arb. **rigan-i** < gr. mes. ose gr. re η ρίγανη (i rigani)

❖ **Prapashtesa të tjera greke në arbërishte të depërtuara bashkë me njësitë leksikore greke janë:**

- arb. **–all** < gr. **–αλ-** p.sh.: kafkall-i < gr. re το καύκαλο (to kafkalo), it. mascelle, riferito ad alcuni quadrupedi;
arb. rruhall-i < gr. re το ρόχαλο (to rohalo), it. rantolo;
- arb. **–ak-, –ëk-,** < gr. **–άκ-** p.sh.: farmëk-u < gr. vj. ose gr. mes. το φαρμακον; ndërsa “farmak” në të folmet e tjera arbëreshë (p.sh: Santa Sofia) < gr. re ose gr. mes. το φαρμάκι / to farmaqi;
mustak-u < gr. re το μουστάκι (to mustaki);
- arb. **–ea** < gr. re **–ια-** p.sh.: kollogréa < gr. re η καλόγρια (i kalogria);
fuléa < gr. re η φωλεά, η φωλιά (i folia).
- arb. **–er-** < gr. **–έρ-** p.sh.: hjirumér-i < gr. re το χοιρομέρι (to hjiromeri, qiromeri) “copë mishi i tymosur”.
- arb. **–ir** < gr. **–υρ-** p.sh.: martir-i < gr. re ο μάρτυρας (o martiras) “dëshmitar”;

parathir/e-ja < gr. re το παράθυρο (to parathiri) “hapësirë e çarë në mur”; nikuqir/e-ja < gr. re η νοικοκυρά (i nikoqira) “grua që do vetminë”.

- arb. **-iz** < gr. **-ίος** p.sh.: qepariz-i < gr. re το κυπαρίσσι (to hji-parisi, qiparisi).
- arb. **-om** < gr. **-ωμ** p.sh.: halkom/ë-a < gr. re το χάλκωμα (to halkoma), it. paiuolo;
- arb. **-on** < gr. **-ον** p.sh.: thron-i < gr. mes. ο θρόνος (o thronos); dhimon-i < gr. re ο δαίμονας (o dhemonas); gjiton-i < gr. re ο γείτονας (o gjitonas).
- arb. **-oq** < gr. **-ώγι** p.sh.: katoq-i < gr. re το κατώγι (to katogji) “katua, magazinë, depo nën tokë”;
- arb. **-ul** < gr. **-ούλ** p.sh.: cakul/e-ja < gr. re το σακκούλι (to cakuli) “thes i madh”; kukul/e-ja < gr. re το κουκούλι (to kukuli) < lat. cucullus, it. bozzolo.
- arb. **-un** < gr. **-υν** p.sh.: takun, alb. takë – it. il tacco dhe në gr. re το τακούνι (takuni) < kjo me burim nga fr. taquet kunj druri, shkopi i bilardos.

Edhe në arbërishte, sikurse edhe në gjuhët e tjera ballkanike, greqizmat foljore kanë hyrë **nga koha e aoristit, duke paraqitur ndajshtesat që rrjedhin nga tema e kohës së kryer të thjeshtë të greqishtes.**

Huazimet foljore greke përfshihen në zgjedhimin e dytë të foljeve që mbaron me bashkëtingëllore në temë, të cilave u bashkëlidhet prapashtesa e vjetër e shqipes *-nj* që sot në trajtën standarde *-j* (vetëm në zgjedhimin e foljeve me temë në zanore).

- as [nga morfema e aoristit -as(a)], dhjvasinj “lexoj”
- es [nga morfema e aoristit -es(a)], ftesenj “kam faj”
- is [nga morfema e aoristit -is(a)], rrukullisënj “rrëkëllej”
- os [nga morfema e aoristit -ós(a)], farmakosënj “helmoj, hidhëroj”
- aks [nga morfema e aoristit -ax(a)], pataksënj “çudit”, “zë në befasi”, qëlloj”.
- eks [nga morfema e aoristit -ex(a)], porseksënj “dallopj”, “vë re”.
- aps [nga morfema e aoristit -ay(a)], papsënj “fashit, qetësoj, paqësoj”.
- eps [nga morfema e aoristit -ey(a)], jatreprsënj “mjekoj, shëroj”.

-ips-[nga morfema e aoristit -iy(a)], lipset “duhet, nevojitet”.

Një tjetër nënçështje me interes është dallimi apo zhvillimi semantik i njësive leksikore të përbashkëta greke të arbërishtes me shqipen p.sh.:

aguridhe-ja < gr. *αγουρίδα* “fruta e papjekur”; edhe në arb. njësia emër aguridhe-ja “fruti i papjekur” ka dhënë mb. agurith (i,e,të) “i/e papjekur për frutat”; ndërsa në shq. mb. aguridh/e është zgjeruar semantikisht “vajzë apo djalë të papjekur, të pamaturuar”.

kremastar-i < gr. *κρεμαστάρι*, si në gr. edhe në shq. përdoret për *frutat e varura* (1) dhe kupt. (2) *varëse rrobash*; ndërkaq në arb. ka depërtuar vetëm me kuptimin e parë “bistak rrushi”.

Prapashtesat dhe parashtesat greke i janë bashkëlidhur, gjithashtu, temave të njësive leksikore të shqipes sipas tipologjive më poshtë:

copj/as-ënj < coptonj < copë – it. spezzettare

uri/ps-ënj “i uritur” < emri *uri* + prap. *ps* + mb. *ënj*

thonj/as-ënj “*pres thonjtë*” < thonjë + prap. *gr.as*

a/shpresë-a < a+shpresë – pashpresë

dhis/pëlqenj < më vjen keq, nuk më pëlqen

Njësitë leksikore të përbëra nga një njësi të shqipes me një njësi të gr. p.sh.:

buzë/gajdhur-e; vesh/gajdhur-e; kocë/gajdhur-e - shq. “kokëfort-e”

këmbë/stisurë-a – shq. “themel”;

koca/rahj-i – shq. “kodër”

Sipas tipologjisë së mëposhtme kemi evidentuar një numër të madh formimesh hibride italo-greke, që të bën të mendosh për një përhapje të madhe dhe të vjetër të këtij formimi ende i gjallë në strukturat më të thella të leksikut të këtyre varieteteve dialektore arbëreshe p.sh.:

Bazë leksikore it. ose varianteve dialektore it. ose bazë leksikore e shq.+prapashtesë greke + mbaresë e vjetër e shqipes

strak/os-ënj “lodh, copëtoj” < it. stancare, strapazzare; strak/osur (i,e,të).

ngolisënj “incollare” < n+rrënjë golë > ngolë + is + ënj “ngjis”

stirandasënj = stir < “stirare” (hekuros) + “adhjas(ënj)” (rregulloj, përgatis) > stri/andas/ënj “shtrij rrobat per hekurosje”

çotjasënj – çotj/as/ënj “trullos”

fallopjasënj – fallopj/as/ënj “gllabëroj”

ajërisënj – ajër/is/ënj “mbush me ajër, pastroj me ajër”

Në lidhje me shtresën leksikore të shqipes apo të arbërishtes kemi evidentuar disa formime të reja leksiko-semantike nga brumi i shqipes, apo njësi të shqipes mesjetare ose të vjetër, të cilat nuk ekzistojnë në leksikun e shqipes së sotme dhe vazhdojnë të përdoren (ose të ruhen) në të folmet arbëreshe p.sh.:

afërdet-i “bregdet” – (parafj.) afër + det

bënjapjesëm-smi “1. përfaqësues, 2. toger” < bënj “bëj” + pjesë(m) – smi

bënjtar-i “poet, krijues, autor, punëtor” < bënj-tar

dritësore-ja “dritare”

tëfal-ënj “përshtëndes” ose të falur-it “përshtëndetje”

vapëhti- a “varfëri”; vapëhtonj “varfëroj” < shq. Vapë

Depërtimi i njësive leksikore italiane apo njësive nga dialektet italiane, të cilave u bashkëlidhen prapashtesat dhe mbaresat e shqipes apo arbërishtes ndeshet mjaft shpesh në ligjërimin e këtyre të folmeve arbëreshe p.sh.:

bëzonjë-a “nevojë, domosdoshmëri” < it. bisogno, necessità

sallvonj “shpëtoj” < “salvare”

donati-a “dhunti-a” < it. dono

dragunarë-a, dragunorë-a “kohë e keqe” < tempesta, uragano.

Njësia bën pjesë në familjen e dragua-oi < it. drago, leone, diavolo + prapashtesat e shq.-n-arë-, -n-orë-.

stivall-i “çizme” < it. stivale

Përfundime:

Më shumë se 15% të huazimeve leksikore të arbërishtes e përbëjnë huazimet leksikore nga it.; dialektet jugore të saj, si dhe nga gr. e re dhe mesjetare.

Afërsisht 35% e leksikut “arbëresh”, sikurse ka pohuar edhe leksikografi Giordano në parathënien e fjalorit të arbëreshëve të Italisë, duke mos qenë i përbashkët me leksikun e “shqipes”, dhe as e

evidentueshme prejardhja nga gjuhët e tjera, duhet të jetë nën shqyrtim rigoroz të kritikës së filologëve, albanologëve dhe leksikologëve kompetentë.

Bashkekzistenca e shumë sistemeve gjuhësore, gjatë rrjedhjes së shekujve, e ka pasuruar dhe kompleksizuar njëkohësisht sistemin gjuhësor të arbërishtes me huazimeve leksiko-morfologjike pothuajse të të gjitha fushave leksiko-semantike.

Gjuha italiane, varietetet gjuhësore vendore të saj, si dhe kontakti i ngushtë me greqishten janë pasqyruar pastër në kombinimet hibride (të kryqëzuara) në strukturën e një njësie të vetme leksikore, duke na dhënë tipologji apo fjalëformime të ndryshme përfshirë tri sistemet kryesore gjuhësore.

Prania e lartë e elementit të huazuar grek qoftë në sistemin emëror dhe sidomos atë foljor nga aoristi ose e kryera e thjeshtë e foljeve ka pasuruar fondin leksiko-morfologjik të arbërishtes duke e karakterizuar dhe veçuar atë në krahasim me varietetet e tjera gjuhësore.

Tipari i ruajtjes apo formimeve leksikore me brumin e shqipes në të folmet arbëreshe është me mjaft interes për t'u trajtuar hollësisht në studimet e ardhshme.

BIBLIOGRAFI

Altimari, F., *Disa ndikime të greqishtes në fjalëformimin foljor të arbërishtes së Italisë*, *Studia Linguistica Italo-Albanica*, Arbërishtja në kontekstin gjuhësor ballkanik dhe italian, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kososvës, Botime të veçanta CXXXIX, Seksioni i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Libri 51. Prishtinë 2014, f. 113.

Banfi, E., *Linguistica Balcanica*, Bologna, (1989).

Baffa, G., *Dizionario arbëresh di Santa Sofia d'Epiro*, Presentazione di Giovanni Belluscio, Università della Calabria, Dipartimento di Linguistica, Sezione di Albanologia, Fondazione Universitaria "Francesco Solano".

Giordano, E., *Fjalori i arbëreshëvet të Italisë*, 2000.

De Rada, G., *Opera Omnia VI, Skanderbeku i pafan (Skanderbeg senturato)*, Edizione critica e traduzione italiana a cura di Vincenzo Belmonte, "Classici della letteratura arbëreshe" collana diretta da Francesco Altimari, Rubbettino 2005.

- Del Puente, P., *Lessico inverso del "Dizionario degli Albanesi d'Italia"* di E. Giordano, Università degli Studi di Salerno, Istituto di Linguistica, Cattedra di Glottologia, Napoli, 1991.
- I dialetti italo-albanesi*, Studi linguistici e storico-culturali sulle comunità arbëreshe a cura di Francesco Altimari e Leonardo M. Savoia, (1994).
- Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, 1980
- Scutari, P., *Dizionario arbëresh di San Costantino Albanese*, Prezantuar nga Francesco Altimari, Università della Calabria, Departamenti i Linguistikës, Seksioni i Albanologjisë, (2010).
- Scutari, P., *Spigolature lessicali sulla parlata degli arbëreshe di S. Costantino Albanese* (1991).
- Ullrich, G., *Doktoratura Neugriechische Lehnwörter im Albanische* (1964).
- Xhuvani, A., Çabej, E., *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Universiteti i Tiranës, Instituti i Historisë së Gjuhësisë, Tiranë, 1962.

